



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KESHILLI BASHKIAK  
GRAMSH



Nr. 1633

Gramsh më 20/06/2026

**PROJEKT-VENDIM**

Nr. \_\_\_ Date \_\_\_/\_\_\_/2026

**PËR**

**DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PER MUAIN MARS 2026 (FONDI 6%)**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës \_\_\_/\_\_\_/2026, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin e Drejtorisë së Shërbimeve dhe Mbrojtjes Sociale, Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Aftësisë së Kufizuar "Për dhënie e ndihmës Ekonomike nga fondi 6% për muajin **mars 2026**" mbështetur në Ligjin Nr 57 dt 18.07.2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë, Neni 21; VKM Nr.597 datë 04.09.2019 si dhe në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për veteqeverisjen vendore" neni 8, pika 2; neni 9 ,pika 1.1/a dhe 1.1/b si dhe neni 54 pika (k) dhe (n);

**VENDOSI:**

1 Të përfitojnë Ndihmë Ekonomike 44 familje me një fond prej **194.794** lekë sipas tabelës së mëposhtme:

Njësia adm:	Nr	Emri i Aplikantit	NID	Nr Aplikimit	Statusi aplikimit	Vlera për fondin 6%	Kom:i Energjis ë	Totali	Nr An ëta rë.
Gramsh	1	Qazime Rustem Meta	G05725070E	NE-2021-024062	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2178.00		2178.00	2
	2	Bujar Ali Qyra	H10123023D	NE-2024-021807	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	0.00	1288.00	1288.00	1
	3	Leonora Zahmeti Dragoti	H75416201B	NE-2024-024807	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2178.00	1288.00	3466.00	2
	4	Ermira Luan Shuli	J05227021V	NE-2024-028048	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5940.00		5940.00	3
	5	Fiqirete Pellumb Vela	G76227112Q	NE-2025-005392	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2178.00		2178.00	1
	6	Rudina Veli Huta	I55910079O	NE-2025-008967	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	7920.00		7920.00	3
	7	Izaura Artur Dulja	I75626114L	NE-2025-014765	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5940.00		5940.00	2
	8	Hurma Shefit Muça	G55906038C	NE-2025-014986	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3146.00	1288.00	4434.00	1
	9	Alma Meleq Sula	I45912015S	NE-2025-015000	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2178.00		2178.00	1
	10	Yllka Sefer Doko	H85201242A	NE-2025-015233	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2178.00		2178.00	1


	11	Alma Muharrem Brahimi	H35108049C	NE-2025-016679	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2178.00		2178.00	1
	12	Arta Ramazan Latollari	H15107044B	NE-2025-019718	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3703.00	1288.00	4991.00	2
	13	Besjana Kujtim Hoxha	J15606107P	NE-2025-019723	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2178.00		2178.00	1
	14	Roland Faik Rrengo	H41125140O	NE-2025-023427	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2178.00		2178.00	1
	15	Greta Skënder Çela	J06120014C	NE-2025-024940	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5940.00		5940.00	2
	16	Ezmira Abedin Kasmi	I75904026T	NE-2026-000250	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	12672.00		12672.00	5
	17	Flora Shyqo Haxhia	G65407150A	NE-2026-000925	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3146.00		3146.00	1
	18	Dritan Shefit Berdellima	H00107065M	NE-2026-005926	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2178.00		2178.00	1
	18	<b>Total Njësia Adm: Gramsh</b>				68009.00	5152.00	73161.00	31
Kushove	1	Naxhire Selim Bora	H15405044A	NE-2023-014161	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2178.00		2178.00	1
	2	Rajmonda Ramadan Kapllani	H05607077O	NE-2023-014787	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2178.00		2178.00	1
	3	Thoma Xhaferr Bora	G91012048I	NE-2025-022133	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5227.00		5227.00	3
	3	<b>Total Njësia Adm: Kushove</b>				9583.00		9583.00	5
Pishaj	1	Nuri Myftar Kotorri	F70116003E	NE-2018-007419	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3703.00	1288.00	4991.00	2
	2	Naxhije Mustafa Çela	G55209131P	NE-2024-021348	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3146.00		3146.00	1
	3	Ramazane Rexhep Ahmati	F85605013F	NE-2024-022412	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3146.00		3146.00	1
	4	Lirije Banush Mesiti	G45505047G	NE-2025-001690	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3146.00	1288.00	4434.00	1
	5	Shpresa Luman Kovaçi	F95712015O	NE-2025-014973	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3146.00	1288.00	4434.00	1
	6	Drita Kasem Kula	G65404201E	NE-2025-015194	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3146.00	1288.00	4434.00	1
	7	Ervin Ali Paja	I90903018P	NE-2025-021004	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	8712.00		8712.00	5
	8	Flora Muharrem Shurdha	G65125048M	NE-2025-024935	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3146.00	1288.00	4434.00	1
	8	<b>Total Njësia Adm: Pishaj</b>				31291.00	6440.00	37731.00	13
Sult	1	Abedin Dule Miraka	F81021007P	NE-2017-058523	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3703.00	1288.00	4991.00	3
	2	Nefail Refit Verça	G40920013H	NE-2022-021711	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3049.00	1288.00	4337.00	3
	3	Fatushe Osman Jança	F45522018I	NE-2025-017667	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3049.00		3049.00	2
	4	Haki Hysen Dermyshe	F70220047S	NE-2025-025098	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3703.00	1288.00	4991.00	2

	4	<b>Total Njësia Adm: Sult</b>				13504.00	3864.00	17368.00	10
Tunje	1	Neim Nexhip Senja	G00404035H	NE-2018-090821	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3703.00	1288.00	4991.00	2
	2	Leonard Barjam Miraka	I40830016L	NE-2023-016345	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5881.00		5881.00	4
	3	Anila Agron LLalla	J06023014O	NE-2023-031504	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	7920.00		7920.00	3
	4	Xhelal Osman Zaimi	F90706014M	NE-2024-005985	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3703.00	1288.00	4991.00	2
	5	Niko Aleksander Rama	G40223015R	NE-2024-008531	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3703.00	1288.00	4991.00	2
	6	Resmije File Murati	F76031002L	NE-2024-011999	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3146.00	1288.00	4434.00	1
	7	Çaush Feta Hoxha	G90620031B	NE-2024-015424	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2178.00	1288.00	3466.00	2
	8	Hysen Barjam Barçi	G20212034M	NE-2024-015576	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3703.00	1288.00	4991.00	2
	9	Xhevair Mehdi Tabaku	F20824006P	NE-2024-016503	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3049.00	1288.00	4337.00	3
	10	Dritan Riza Miraka	H20330016Q	NE-2024-016640	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5227.00	1288.00	6515.00	3
	11	Hava Tahir Salla	F85129033J	NE-2025-021481	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3146.00	1288.00	4434.00	1
	11	<b>Total Njësia Adm: Tunje</b>				45359.00	11592.00	56951.00	25
<b>Total Bashkia: Gramsh</b>	44					167746.00	27048.00	194794.00	84
	44					167746.00	27048.00	194794.00	84
	44					167746.00	27048.00	194794.00	84


**Dr.Drej.Shërbimeve dhe Mbrojtjes Sociale**  
Elisabeta Xhepexhiu



**Sekretari Keshillit**  
Xhulia Gjini



**Dr.Drej. Finances dhe Buxhetit**  
Ermal Hysa



**Kryetari Keshillit**  
Enis Zani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
KRYETARI

Nr. 1665 Prot

Gramsh, më 22.04.2026

RELACION  
PËR  
PROJEKT VENDIM

PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURËN E VLERËSIMIT TË  
PERFORMANCËS SË DREJTUESVE TË KOPSHTEVE

**Të nderuar Këshilltarë!**

Bazuar në nenin 8 pika 2, nenin 9 pika 1/1.1 gërma "b", nenin 23 pika 12, neni 24 pika 1, nenin 54 gërma "k", neni 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar, propozojmë të miratohet nga Këshilli Bashkiak, Projekt-vendimi "Për miratimin e Rregullores për procedurën e vlerësimit të performancës së drejtuesve të kopshteve".

Qëllimi i kësaj rregullore është krijimi i një kuadri rregullator për mënyrën e vlerësimit të Performancës së Drejtuesve të Kopshteve, për një veprimtari më efçente dhe transparente ndaj të tretëve, të përcaktuar nga aktet ligjore dhe nënligjore të Republikës së Shqipërisë

Hartimi i instrumentit të vlerësimit të performancës së drejtuesit të kopshtit, synon të standardizojë objektivat/treguesit të cilët do të masin performancën e drejtuesit të kopshtit. Instrumenti i vlerësimit do të bazohet ngushtësisht tek Standardet e Drejtuesit të kopshtit, dhe tek **Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"** i ndryshuar, i cili i kalon Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore të drejtën për të emëruar Drejtuesit e Institucioneve të Arsimit Parashkollor. Për këtë arsye, është tejet e rëndësishme që duke u bazuar në këto dy dokumente, Bashkia të masë edhe performancën e drejtuesve të kopshteve.

Vlerësimi i Drejtuesit të kopshtit nga ana e Bashkisë, synon të vlerësojë në mënyrë të drejtpërdrejtë, standardet që lidhen ngushtë me menaxhimin efektiv të kopshtit. Ndërkohë përsa i përket implementimit të kurrikulës /programit të kopshtit, këtë standard e vlerëson në mënyrë të drejtpërdrejt Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar.

Duke vlerësuar përmbajtjen e Rregullores, dokumentacionin shoqërues (shtojcat), domosdoshmërinë për vlerësimin e performancës së drejtuesit të kopshteve të Bashkisë Gramsh,

mbështetur në nenin 8 pika 2, nenin 9 pika 1/1.1 gërma "b", nenin 23 pika 12, neni 24 pika 1, nenin 54 gërma "k", neni 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, paraqesim për shqyrtim dhe miratim projekt vendimin "**Për miratimin e Rregullores për procedurën e vlerësimit të performancës së drejtuesve të kopshteve**", që do të shërbejnë për vlerësimin në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtuesve të kopshteve, sipas standardeve që lidhen ngushtë me menaxhimin efektiv të IAP-ve, si dhe monitorimit të veprimtarisë së tyre.

Këtij relacioni i bashkëlidhet Rregullorja "Për procedurën e vlerësimit të performancës së drejtuesve të kopshteve", së bashku me shtojcat, pjesë integrale e rregullores.

Me konsideratë,

Drejtori DSHS  
Isa BASHA

Drejtori AFP  
Ada GUZI





---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
AGJENCIA E FUNKSIONEVE TË PATRANSFERUESHME  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE



**RREGULLORE**  
**“PËR**  
**PROCEDURËN E VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS**  
**SË DREJTUESVE TË KOPSHTEVE”**

## NENI 1 QËLLIMI

Qëllimi i kësaj rregullore është krijimi i një kuadri rregullator për mënyrën e vlerësimit të Performancës së Drejtuesve të Kopshteve, për një veprimtari më eficiente dhe transparente ndaj të tretëve, të percaktuar nga aktet ligjore dhe nënligjore të Republikës së Shqipërisë.

## NENI 2 BAZA LIGJORE

Kjo rregullore hartohet bazuar në:

Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;

Ligji Nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar.

## NENI 3 PARIMET E VEPRIMTARISË

Vlerësimi do të zhvillohet bazuar në parimin e:

- a) ligjshmërisë;
- b) pavarësisë;
- c) përgjegjshmërisë në marrjen e vendimeve;
- d) drejtësisë dhe paanësisë;
- e) transparencës;
- f) profesionalizmit, cilësisë, eficientës dhe efektivitetit të shërbimit;
- g) ruajtjes së konfidencialitetit;
- h) papranueshmërisë së konfliktit të interesit.

## NENI 4 VLERËSUESIT

Drejtoria e Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë, që mbulon arsimin parashkollor, në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore do të zhvillojnë procedurën e vlerësimit të performancës së drejtuesve të institucioneve arsimore parashkollore.

## NENI 5 INSTRUMENTET E VLERËSIMIT

1. Instrumentat e vlerësimit do të jenë:
  - a. **Formulari i vetëvlerësimit** i cili do të zhvillohet me një formular me format standard të plotësuar nga vet drejtuesi i kopshtit;
  - b. Formulari do të përmbajë vlerësim për performancën e drejtuesit lidhur me proceset në shërbim të arsimit parashkollor, standardet e shërbimit nën përgjegjësinë e drejtuesit të Institucionit Arsimor Parashkollor dhe Standardet e drejtuesit të kopshtit që lidhen me fushën e menaxhimit të Institucionit Arsimor Parashkollor;
  - c. Shpërndarja e formularëve të vetëvlerësimit do të bëhet në mënyrë elektronike, por dorëzimi do të bëhet pranë Bashkisë.
  - d. Formulari duhet të dorëzohet i plotësuar në çdo fushë dhe i nënshkruar nga drejtuesi i kopshtit.
  - e. Mosdorëzimi i formularëve do të konsiderohet ulje në pikët e vlerësimit përfundimtar.

2. **Pyetësorët** që do të shërbejnë për vlerësimin nga Bashkia dhe do të zhvillohen në formë elektronike **2 herë në vitë shkollor** përpara vlerësimit përfundimtar;
  - a. Pyetësorët do të zhvillohen nga Njësia për Arsimin Parashkollor në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe do të hartohen në formë standarde për tre subjekte (përfaqësuesi i njësisë vendore pranë *Bordit të kopshtit, prindërit e fëmijëve frekuentues të kopshtit dhe mësues të kopshtit*);
  - b. Pyetësorët do të strukturohen me pyetje të mbyllura, për t'u përgjigjur duke zgjedhur një nga opsionet e paracaktuara (**Po/Jo**) si përgjigje;
  - c. Në hartimin dhe përdorimin e pyetësorëve në vetëvlerësimin e tij, vlerësuesit duhet:
    - të përcaktojnë paraprakisht, se çfarë informacioni synojnë të mbledhin;
    - të shpjegojnë pse i kërkojnë mendimet e të anketuarve;
    - të sigurojnë anonimin dhe konfidencialitetin e të anketuarve;
    - të kufizojnë numrin e pyetjeve të bëra;
    - të shmangin pyetjet e panevojshme;
    - të shmangin pyetjet sugjestive;
    - të strukturojnë pyetësorin në mënyrë të qartë dhe logjike;
    - të hartojnë udhëzime të qarta dhe të thjeshta;
    - të përshtasin gjuhën e pyetësorit me nivelin e të anketuarve;
    - të gjykojnë paraprakisht, se si do të përdoren informacionet e mbledhura përmes pyetësorit.
3. **Formulari i Vlerësimit** do jetë me një format standard dhe do përmbajë:
  - a. Vlerësim për proceset në shërbimin për arsimin parashkollor;
  - b. Vlerësim për standardet e shërbimit nën përgjegjësinë e drejtuesit të kopshtit.

#### **NENI 6**

#### **BURIMET E VLERËSIMIT**

1. Burime të vlerësimit do të konsiderohet dokumentacioni të cilin duhet ta zotërojë cdo drejtor kopshti, dhe mbi të cilën do të bazohet Bashkia për të vlerësuar performancën e Drejtorit të kopshtit.
2. Burimet e vlerësimit do të përcaktohen nga Bashkia dhe do të dorëzohen nga Drejtuesi i kopshtit së bashku me formularët e vetëvlerësimit.

#### **NENI 7**

#### **PROCEDURA E VLERËSIMIT**

1. Procedura e vlerësimit do të zhvillohet në pesë etapa:
  - a) Plotësimi dhe dorëzimi i Formularëve të vetëvlerësimit nga drejtuesit e kopshteve;
  - b) Zhvillimi i pyetësorëve nga Njësia për Arsimin Parashkollor pranë Bashkisë;
  - c) Mbledhja e të dhënave nga vlerësuesit nëpërmjet instrumentave të vlerësimit;
  - d) Analizimi i të dhënave nga vlerësuesit;
  - e) Gjykimi mbi analizën e të dhënave dhe vlerësimi përfundimtar.

#### **NENI 8**

#### **NJOFTIMI I DREJTUESIT TË KOPSHTIT PËR PROCESIN E VLERËSIMIT**

Njoftimi i drejtuesit të kopshtit bëhet nga Njësia e Arsimit Parashkollor pranë Bashkisë, **10-15 ditë** para fillimit të procesit të vlerësimit.

## NENI 9

### TË DREJTAT E DREJTUESIT TË KOPSHTIT GJATË PROCESIT TË VLERËSIMIT

#### Drejtori i kopshtit ka të drejtë:

- a) të njihet me qëllimin/objektivat dhe treguesit për të cilët do të vlerësohet, para fillimit të procesit të vlerësimit;
- b) të njihet me të gjithë anëtarët e ekipit të vlerësimit;
- c) të kërkojë dhe të marrë informacion nga vlerësuesi mbi metodologjinë e vlerësimit;
- d) të paraqesë me shkrim apo me gojë, mendimet, shpjegimet për faktet, rrethanat që kanë të bëjnë me vlerësimin;
- e) të paraqesë me shkrim apo me gojë, propozimet e tij për zgjidhjen e çështjes/ve dhe dokumentet përkatëse për çështjet ligjore që kanë të bëjnë me vlerësimin;
- f) të paraqesë me shkrim kontestimet e tij për përfundimet e vlerësuesve, në përputhje me procedurat e ankimit.

## NENI 10

### DETYRAT E DREJTORIT TË KOPSHTIT GJATË PROCESIT TË VLERËSIMIT

#### Drejtori i kopshtit ka për detyrë që gjatë procesit të vlerësimit:

- a) të komunikojë me vlerësuesit ose të caktojë një përfaqësues, për të komunikuar kur ai nuk e ka të mundur;
- b) të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e veprimeve të vlerësimit;
- c) të paraqesë çdo informacion, dokument dhe të japë çdo shpjegim për faktet e rrethanat e konstatuara dhe të nevojshme për vlerësimin, brenda afateve të përcaktuara nga vlerësuesi;
- d) të lejojë dhe të mundësojë zhvillimin e anketave/pyetësorëve/intervistave/fokus grupe me mësues dhe prindër.

## NENI 11

### MASA DISIPLINORE

1. Vlerësuesi vendos masën disiplinore për Drejtuesin e Institucionit Arsimor Parashkollor, kur konstaton:
  - a) shkelje të dispozitave ligjore që kanë lidhje me arsimin dhe drejtimin e kopshtit;
  - b) moskryerjes të detyrave sipas përshkrimeve të punës;
  - c) mospërbushje të standardeve të shërbimit;
  - d) mospërbushje të standardeve që lidhen me fushën menaxhuese dhe drejtuese të institucionit arsimor parauniversitar;
  - e) përsëritje të rezultateve të ulta në vlerësimin e performancës tre herë rradhazi.
2. Masat që vlerësuesit vendosin për Drejtuesin e Institucionit Arsimor Parashkollor, janë:
  - a) vërejtje;
  - b) paralajmërim për largim nga puna;
  - c) largim nga puna.

## NENI 12

### E DREJTA E ANKIMIT

1. Në rastet kur drejtuesi i kopshtit nuk bie dakort me vlerësimin e marrë, atij i lind e drejta e ankimit tek Kryetari i Bashkisë për kontestimet që ka në një afat kohor brenda 15 ditësh.

2. Drejtuesi ka të drejtë të paraqesi tek Kryetari i Bashkisë ankesë me shkrim ku reflekton të gjitha argumentat e tij.
3. Pasi shqyrtohen kontestimet, Kryetari i Bashkisë vendos nëse do të mbetet në fuqi vlerësimi i dhënë apo do të ndryshojë bazuar në kontestimet e drejtuesit të kopshtit.
4. Në rastet kur drejtuesi nuk është dakort edhe me vendimin e Kryetarit të Bashkisë, ai ka të drejtë të vazhdojë ankimim në rrugë gjyqësore duke u bazuar në çfarë parashikohet në aktet ligjore/nënligjore.

#### **NENI 13**

#### **FORMULARI I VLERËSIMIT**

1. Vlerësimi do të jetë një dokument i strukturuar, që përmban gjetjet, gjykimet, vlerësimet e përshkruesve praktik, për secilin tregues, rekomandimet, si dhe, nëse është e nevojshme masat disiplinore.
2. Në fund të vlerësimit, Drejtoria e Shërbimeve Sociale (Njësia për Arsimin Parashkollor) dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore do të njoftojnë Drejtuesin e kopshtit për t'u paraqitur pranë ambienteve të Bashkisë për t'u vënë në dijeni të vlerësimit të performancës përgjatë një viti shkollor.

#### **NENI 14**

#### **RISHIKIMI I RREGULLORE**

1. Rregullorja e Komisionit, rishikohet ose ndryshon vetëm me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë.
2. Në rastin kur ka ndryshime ose rishikime të:
  - Ligjit të Arsimit Parauniversitar;
  - Ligjit për vetëqeverisjen vendore;

Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës"

Përkatësisht nenet që lidhen me drejtuesin e institucionit të arsimit parauniversitar dhe marrëdhëniet e punës.

3. Kryetari i Bashkisë merr në shqyrtim rregulloren, procedon për ndryshimet përkatëse dhe miraton rregulloren e re të ndryshuar.

#### **NENI 15**

#### **HYRJA NË FUQI**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Këshilli i Bashkisë.

SHTOJCA 1

Formulari i Vlerësimit të Drejtuesit të Institucionit Arsimor Parashkollor

Emri/Mbiemri: \_\_\_\_\_ (i drejtuesit të kopshtit për të cilin zhvillohet vlerësimi)

Kopshti: \_\_\_\_\_

Data e emërimit në pozicionin aktual: \_\_\_\_\_

Periodha e vlerësimit: \_\_\_\_\_ Data e vlerësimit: \_\_\_\_\_

Njësia e vetëqeverisjes vendore, Bashkia: \_\_\_\_\_

Ndarja A: Standardet dhe proceset në shërbimin për arsimin parashkollor.

Standardet profesionale për drejtuesin e kopshtit				
Misioni, vizioni dhe plani i zhvillimit të kopshtit	1	2	3	4
Drejtuesi i kopshtit ka drejtuar grupet e punës për hartimin dhe zbatimin e planeve zhvillimore strategjike në përmbushje të vizionit të kopshtit, duke përcaktuar qartë përparësitë, synimet, objektivat, veprimtaritë kryesore, produktin ose treguesit e arritjeve, si dhe buxhetin e përafërt.				
Drejtuesi i kopshtit realizon çdo vit vlerësimin e brendshëm, në të cilin përfshin të gjithë punonjësit arsimorë të kopshtit dhe psikologun/punonjësin social.				
Ka bashkëpunuar me Njësinë e Qeverisjes Vendore, Zyrën Vendore të Arsimit dhe partnerë të tjerë, për t'u mbështetur në proceset e planifikimit, të zbatimit, të monitorimit dhe të vlerësimit.				
Plani vjetor është hartuar dhe është zbatuar nga grupe pune, të përbërë nga: mësues, persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të fëmijëve, nga këshillat e prindërve dhe përfaqësues të tjerë nga komuniteti.				
Plani afatmesëm i IA-së është i përbërë nga këto rubrika: misioni, vizioni, analiza e gjendjes, përparësitë, veprimtaritë kryesore për realizimin e përparësive, produkti ose treguesit e arritjeve, buxheti i përafërt.				
Drejtuesi/ja ka hartuar rregulloren e brendshme të kopshtit.				
Drejtori i kopshtit ka ngritur grupin e punës për hartimin e rregullores së brendshme, me mësues, prindër dhe përfaqësues të tjerë të komunitetit.				
Drejtori udhëheq planifikimin dhe zbatimin e planeve të zhvillimit të kopshtit, në funksion të zhvillimit të kompetencave kyçe të arsimit parashkollor, me qëllim edukimin dhe formimin cilësor të të gjithë fëmijëve.				

Drejtuesi ka ndërtuar partneritetin me familjet dhe komunitetin për të fuqizuar rolin e tyre në rritjen e të nxënit dhe zhvillimin e fëmijëve.				
Drejtuesi ka hartuar planin e përmirësimit bazuar në raportin e vlerësimit të brendshëm.				
<b>Udhëheqja e ndryshimeve brenda institucionit arsimor</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>
Drejtuesi/ja ka drejtuar dhe menaxhuar ndryshimet brenda institucionit duke u bazuar tek dokumentet ligjore në fuqi ( <i>udhëzimet e bashkisë, udhëzimet e MASR</i> ).				
<i>Ka vlerësuar gjithëpërfshirjen si një proces që sjell përfitime, duke bërë që secili në kopsht fëmijë, prind, staf të jetë pranues, jodiskriminues dhe mbështetës ndaj të tjerëve.</i>				
Ka krijuar një mjedis të sigurt, stimulues dhe të qëndrueshëm.				
Drejtuesi i kopshtit ka mbështetur fëmijët dhe ka mbrojtur të drejtat e tyre duke zbatuar legjislacionin dhe vlerat shqiptare për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.				
<b>Partneriteti kopsht-familje-komunitet dhe bashkëpunimet ndërinstitucionale</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>
<i>Ka krijuar bashkëpunime me institucionet e tjera dhe me rrjetet profesionale për të ndarë praktikat të suksesshme.</i>				
<i>Ka krijuar dhe mbajtur marrëdhënie pozitive, bashkëpunuese dhe produktive me familjet dhe komunitetin, duke i bërë pjesëmarrës në vendimmarrje të rëndësishme për jetën dhe veprimtarinë e kopshtit.</i>				
<i>Ka bashkëpunuar në projekte dhe veprimtari të përbashkëta me grupet e interesit, për përmirësimin e institucionit.</i>				
Ka planifikuar veprimtari për përfshirjen e anëtarëve të komunitetit në jetën e kopshtit, për të ndarë ekspertizën, punën, pasionet dhe traditat e tyre.				
<b>Zhvillimi dhe rritja profesionale</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>
<i>Ka planifikuar dhe menaxhuar planin vjetor të zhvillimit të brendshëm profesional të punonjësve të institucionit arsimor.</i>				
<i>Ka nxitur dhe kontrolluar pjesëmarrjen e stafit në rrjetet profesionale.</i>				
<i>Ka marr pjesë në rrjetet profesionale të drejtuesve, duke ndarë risitë dhe praktikat e frytshme.</i>				
Drejtuesi/ja ka siguruar programe trajnimi për stafin, në bashkëpunim me DPÇK-në, ZVAP-në donatorë të arsimit, ose OJF-të e akredituara, ekspertë në fushën e arsimit etj.				
<b>Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe financiare</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>

<i>Ka qënë i pranishëm çdo ditë në institucion, duke modeluar menaxhimin e përditshëm dhe të frytshëm të stafit, fëmijëve, prindërve dhe komunitetit të gjerë.</i>				
<i>Ka vendosur pritshmëri për të gjithë stafin me qëllim përmirësimin e praktikave të menaxhimit.</i>				
<i>Ka adresuar problematikat për t'u zgjidhur në kohën e duhur, dhe me burimet e duhura.</i>				
<i>Ka menaxhuar burimet financiare dhe burime të tjera të kopshtit, në funksion të shërbime cilësore për fëmijët parashkollorë.</i>				
<i>Ka qënë i përgjegjshëm, transparent dhe realizon procedurat e llogaridhënies personale në përdorimin e burimeve financiare.</i>				
<i>Ka zhvilluar marrëdhënie produktive me Bordin e kopshtit, Njësinë e Qeverisjes Vendore, Njësinë Arsimore Vendore etj.</i>				
<i>Ka ndihmuar komunitetin e kopshtit të njohë kuadrin ligjor, të drejtat dhe detyrat e tyre, në mënyrë që të promovojnë suksesin e fëmijëve.</i>				
<i>Ka ruajtur konfidencialitetin e të dhënave të kopshtit dhe privatësinë.</i>				
<i>Ka përdorur në mënyrë efektive burimet financiare të disponueshme, për të ndikuar maksimalisht në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.</i>				
<i>Drejtuesi/ja i/e kopshtit ka dërguar kërkesën për mësues ndihmës në Njësinë Arsimore pranë Bashkisë së bashku me dokumentet që justifikojnë kërkesën për mësues ndihmës, pas nevojës së shprehur në raportin e komisionit multidisiplinar në ZVAP.</i>				
<i>Drejtuesi/ja disponon dosjet e plotësuara me dokumentacionin përkatës për të gjithë mësuesit e kopshtit.</i>				
<b>Proceset e shërbimit të arsimit parashkollor</b>				
<b>Regjistrimi i fëmijëve në kopsht</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>
<i>Drejtuesi/ja i/e kopshtit ka dërguar në Njësinë e Arsimit Parashkollor listën emërore të fëmijëve të regjistruar dhe dosjet me dokumentacionin e fëmijëve të regjistruar në kopsht, 3 javë pas fillimit të kopshtit dhe në muajin dhjetor.</i>				
<i>Drejtuesi/ja i/e kopshtit para fillimit të procesit të regjistrimit ka urdhëruar ngritjen e një grupi pune të përbërë nga drejtuesi i kopshtit dhe mësuesit për regjistrimet e fëmijëve në kopsht.</i>				
<i>Drejtuesi/ja i/e kopshtit ka organizuar dokumentet për çdo fëmijë në dosje të veçantë.</i>				
<i>Në kopsht janë formuar grupet/klasat në përputhje me <b>Udhëzimin Nr. 14</b>, datë 10.07.2023, "Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar", si dhe <b>Rregulloren "Për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë"</b>, i ndryshuar, miratuar me <b>Urdhrin nr. 31</b>, datë 28.01.2020.</i>				

<b>Organizmat e institucionit arsimor</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>
Organizmat e kopshtit kanë hartuar rregulloret për funksionimin e tyre dhe planet e punës.				
Drejtori realizon detyrat e tij për funksionimin efektiv të secilit organizëm të kopshtit.				
Drejtori i IA-së ka ngritur komisionin e shëndetit, të sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit, të kryesuar prej tij ose një nëndrejtor i ngarkuar prej tij (nëse ka), të përbërë nga mësues të zgjedhur nga këshilli i mësuesve, persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të fëmijëve, të caktuar nga këshilli i prindërve.				
Drejtori i IA-së ka miratuar rregulloren e shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit				
Komisioni i Shëndetit, të Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit ka mbikëqyrur rregullisht në IA kushtet e ruajtjes së shëndetit, të higjienës, pastërtisë, mjedisit, të sigurisë së nxënësve dhe punonjësve, si dhe mirëmbajtjen e mjediseve dhe të pajisjeve.				
Komisioni i Shëndetit, të Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit ka organizuar veprimtari ndërgjegjësuese me nxënës, mësues dhe persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësit, për kushtet e ruajtjes së shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes së mjediseve dhe pajisjeve të institucionit.				
Drejtori i IA-së ka përcaktuar udhëzime të qarta dhe të hollësishme për të përcaktuar masat parandaluese për emergjencat e mundshme.				
<b>Fëmijët me aftësi të kufizuar</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>
Drejtuesi/ja i/e kopshtit pasi është vënë në dijeni për praninë e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopsht, ka bërë kërkesë në Komisionin Multidisiplinor për vlerësimin e nevojave arsimore dhe shoqërore të fëmijës dhe performancës së tij.				
Drejtuesi/ja i/e kopshtit ka ngritur Komisionin e Zakonshëm të Kopshtit para se të raportojë në ZVAP.				
Drejtuesi/ja i/e kopshtit pasi ka identifikuar barrierat infrastrukturore që pengojnë aksesin në kopsht për fëmijët me aftësi të kufizuar i ka listuar dhe i'a ka dërguar Bashkisë bashkë me kërkesën për heqjen e tyre.				
Kopshti identifikon fëmijët me prirje të veçanta, vështirësi në të nxënë dhe me aftësi të kufizuar (AK).				
<b>Materialet</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>
Drejtuesi/ja i/e Kopshtit i ka dërguar çdo muaj Qershor Njësisë së Arsimit Parashkollor pranë Bashkisë, nevojën për materiale didaktike dhe kancelarike.				
Kopshti bashkëpunon me ZVAP-në dhe pushtetin vendor për sigurimin e materialeve mësimore didaktike, literaturën artistike, profesionale dhe shkencore, në funksion të arritjes së rezultateve të të nxënës				

Drejtori ka ngritur komisionet për administrimin e inventarit sipas udhëzimeve zyrtare.				
<b>Ushqimi</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>
Drejtuksi/ja i/e kopshtit ( <i>për kopshtet me drekë</i> ) ka raportuar pranë Njesisë së Arsimit Parashkollor numrin e fëmijëve që frekuentojnë kopshtin.				
Drejtuksi/ja i/e kopshtit i ka dërguar Njesisë së Arsimit Parashkollor pranë Bashkisë, kërkesën për ushqime.				
Drejtuksi/ja i/e kopshtit ka ruajtur ushqimin 24 orë.				
Drejtuksi/ja i/e kopshtit ka planifikuar menunë dhe nevojën për ushqime të fëmijëve që frekuentojnë kopshtin.				
<b>Përfshirja Sociale</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>
Regjistrimi i fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale në kopsht.				
Frekuentimi i rregullt i fëmijëve në nevojë i programit kurrikular.				
<b>Fëmijët në nevojë për mbrojtje</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>
Drejtuksi ka raportuar pranë Bashkisë për rastet e identifikuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje ( <i>të abuzuar ose neglizhuar</i> )				
<b>Higjiena</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>
Kopshti ka hartuar dhe zbaton udhëzime të qarta për mbajtjen e higjienës në të gjitha mjediset e kopshtit.				
Të gjitha mjediset e kopshtit janë të ajrosura dhe të ndriçuara, në përputhje me standardet.				
Drejtori i kopshtit informon dhe bashkëpunon me pushtetin vendor për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e mjediseve të kopshtit në përputhje me standardet kombëtare.				
Drejtuksi ka ndërmarr masat e nevojshme për sigurimin e kushteve higjieno-sanitare në respektim të kuadrit ligjor të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.				
<b>Komente:</b>				

## Ndarja B: Vlerësimi

Vlerësimi	Shkalla	PËRSHKRIMI
4	Shumë mirë	Performanca e Drejtuesit të kopshtit i ka tejkaluar pritshmëritë, duke arritur një cilësi jashtëzakonisht të lartë të punës së kryer në të gjitha fushat. Drejtuesi ka qëllime/synime të larta për performancën e saj. Ky vlerësim është i arritshëm nga çdo punonjës, megjithëse i dhënë rrallë.
3	Mirë	Performanca nuk i tejkalon pritshmëritë në të gjitha fushat e përgjegjësisë dhe cilësia e punës në përgjithësi është e mirë. Prioritetet/objektivat vjetorë janë përmbushur.
2	Mjaftueshëm	Performanca e drejtuesit nuk përputhet në mënyrë të vazhdueshme me pritshmëritë. Performanca nuk ka arritur të përmbushë një ose më shumë nga prioritetet/objektivat e drejtuesit. Është e nevojshme të hartohet një plan zhvillimi profesional për të përmirësuar performancën, duke përcaktuar afatet kohore dhe duke monitoruar në vijimësi matjen e progresit.
1	Dobët	Performanca është nën pritshmëritë, në fushat më të rëndësishme të përgjegjësisë dhe nuk ka asnjë progres drejt prioritetëve. Është i domosdoshëm përmirësimi i menjëhershëm në një ose më shumë fusha të rëndësishme. Nevojitet një plan urgjent për të rritur performancën duke përfshirë afatet kohore, si dhe duhet të monitorohet në vazhdim matja e progresit.

## Ndarja C: Nënshkrimi

1. Unë deklaroj se kam kryer vlerësimin e mësipërm për nëpunësin.

**Nënshkrimi i zyrtarit raportues**

**Data:** .....

2. Unë deklaroj se kam marrë dhe kam lexuar vlerësimin e mësipërm.

- Jam dakort me vlerësimin  
 Nuk jam dakort me vlerësimin

**Nënshkrimi i zyrtarit kundërfirmues**

**Data:** .....

3. Unë deklaroj se kam marrë dhe kam lexuar vlerësimin e mësipërm.

- Jam dakort me vlerësimin  
 Nuk jam dakort me vlerësimin

**Nënshkrimi i zyrtarit autorizues**

**Data:** .....

4. Unë deklaroj se kam marrë dhe kam lexuar vlerësimin e mësipërm.

- Jam dakort me vlerësimin  
 Nuk jam dakort me vlerësimin

**Nënshkrimi i nëpunësit**

**Data :** .....

Unë nëpunësi nuk jam dakort me vlerësimin e mësipërm dhe kërkoj rivlerësim nga ana e zyrtarit autorizues.

Nënshkrimi i nëpunësit

Data: .....

**Ndarja D: Rivlerësimi nga zyrtari autorizues**

1. Unë deklaroj se kam shqyrtuar pretendimet e nëpunësit lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë dhe rivlerësoj si më poshtë:

.....  
.....  
.....  
.....

Nënshkrimi i zyrtarit autorizues

Data: .....

2. Unë deklaroj se kam marrë dhe kam lexuar rivlerësimin nga ana e zyrtarit autorizues.

Jam dakort

Nuk jam dakort

Nënshkrimi i nëpunësit

Data: .....

3. Unë deklaroj se do të ankimoj në rrugë gjyqësore vlerësimin për rezultatet në punë për periudhën

.....  
Nënshkrimi i nëpunësit

Data: .....

**SHTOJCA 2**

Modeli formati standart i formularit me anë të të cilit drejtuesi do të realizojë vetëvlerësimin.

**Formulari i Vetëvlerëimit të Drejtuesit të Institucionit Arsimor Parashkollor**

Emri/Mbiemri: \_\_\_\_\_ (i drejtuesit të kopshtit për të cilin zhvillohet vlerësimi)

Kopshti: \_\_\_\_\_

Data e emërimit në pozicionin aktual: \_\_\_\_\_

Periudha e vlerëimit: \_\_\_\_\_ Data e vlerëimit: \_\_\_\_\_

Njësia e Vetëqeverisjes Vendore, Bashkia: \_\_\_\_\_

Ndarja A: Standardet dhe proceset në shërbimin për arsimin parashkollor.

Standardet profesionale për drejtuesin e kopshtit				
Misioni, vizioni dhe plani i zhvillimit të kopshtit	1	2	3	4
<i>Ka drejtuar grupet e punës për hartimin dhe zbatimin e planeve zhvillimore strategjike në përmbushje të vizionit të kopshtit, duke përcaktuar qartë përparësitë, synimet, objektivat, veprimtaritë kryesore, produktin ose treguesit e arritjeve, si dhe buxhetin e përafërt.</i>				

Drejtuesi i kopshtit realizon çdo vit vlerësimin e brendshëm, në të cilin përfshin të gjithë punonjësit arsimorë të kopshtit dhe psikologun/punonjësin social.				
<i>Ka bashkëpunuar me Njësinë e qeverisjes vendore, Zyrën vendore të arsimit dhe partnerë të tjerë, për t'u mbështetur në proceset e planifikimit, të zbatimit, të monitorimit dhe të vlerësimit.</i>				
Plani vjetor është hartuar dhe është zbatuar nga grupe pune, të përbërë nga: mësues, persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të fëmijëve, nga këshillat e prindërve dhe përfaqësues të tjerë nga komuniteti.				
Plani afatmesëm i IA-së është i përbërë nga këto rubrika: misioni, vizioni, analiza e gjendjes, përparësitë, veprimtaritë kryesore për realizimin e përparësive, produkti ose treguesit e arritjeve, buxheti i përafërt.				
Drejtuesi/ja ka hartuar rregulloren e brendshme të kopshtit.				
Drejtori i kopshtit ka ngritur grupin e punës për hartimin e rregullores së brendshme, me mësues, prindër dhe përfaqësues të tjerë të komunitetit.				
Drejtori udhëheq planifikimin dhe zbatimin e planeve të zhvillimit të kopshtit, në funksion të zhvillimit të kompetencave kyçe të arsimit parashkollor, me qëllim edukimin dhe formimin cilësor të të gjithë fëmijëve.				
Drejtuesi ka ndërtuar partneritetin me familjet dhe komunitetin për të fuqizuar rolin e tyre në rritjen e të nxënësve dhe zhvillimin e fëmijëve.				
Drejtuesi ka hartuar planin e përmirësimit bazuar në raportin e vlerësimit të brendshëm.				
<b>Udhëheqja e ndryshimeve brenda institucionit arsimor</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>
Drejtuesi/ja ka drejtuar dhe menaxhuar ndryshimet brenda institucionit duke u bazuar tek dokumentet ligjore në fuqi ( <i>udhëzimet e bashkisë, udhëzimet e MASR</i> ).				
<i>Ka vlerësuar gjithëpërfshirjen si një proces që sjell përfitime, duke bërë që secili në kopsht fëmijë, prind, staf të jetë pranues, jodiskriminues dhe mbështetës ndaj të tjerëve.</i>				
Ka krijuar një mjedis të sigurt, stimulues dhe të qëndrueshëm.				
Drejtuesi i kopshtit ka mbështetur fëmijët dhe ka mbrojtur të drejtat e tyre duke zbatuar legjisllacionin dhe vlerat shqiptare për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.				
<b>Partneriteti kopsht-familje-komunitet dhe bashkëpunimet ndërinstytucionale</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>
<i>Ka krijuar bashkëpunime me institucionet e tjera dhe me rrjetet profesionale për të ndarë praktikat të suksesshme.</i>				
<i>Ka krijuar dhe mbajtur marrëdhënie pozitive, bashkëpunuese dhe produktive me familjet dhe komunitetin, duke i bërë pjesëmarrës në vendimmarrje të rëndësishme për jetën dhe veprimtarinë e kopshtit.</i>				

<i>Ka bashkëpunuar në projekte dhe veprimtari të përbashkëta me grupet e interesit, për përmirësimin e institucionit.</i>				
<i>Ka planifikuar veprimtari për përfshirjen e anëtarëve të komunitetit në jetën e kopshtit, për të ndarë ekspertizën, punën, pasionet dhe traditat e tyre.</i>				
<b>Zhvillimi dhe rritja profesionale</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>
<i>Ka planifikuar dhe menaxhuar planin vjetor të zhvillimit të brendshëm profesional të punonjësve të institucionit arsimor.</i>				
<i>Ka nxitur dhe kontrolluar pjesëmarrjen e stafit në rrjetet profesionale.</i>				
<i>Ka marr pjesë në rrjetet profesionale të drejtuesve, duke ndarë risitë dhe praktikat e frytshme.</i>				
<i>Drejtuesi/ja ka siguruar programe trajnimi për stafin, në bashkëpunim me DPÇK-në, ZVAP-në, donatorë të arsimit, ose OJF-të e akredituara, ekspertë në fushën e arsimit etj.</i>				
<b>Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe financiare</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>
<i>Ka qënë i pranishëm çdo ditë në institucion, duke modeluar menaxhimin e përditshëm dhe të frytshëm të stafit, fëmijëve, prindërve dhe komunitetit të gjerë.</i>				
<i>Ka vendosur pritshmëri për të gjithë stafin me qëllim përmirësimin e praktikave të menaxhimit.</i>				
<i>Ka adresuar problematikat për t' zgjidhur në kohën e duhur, dhe me burimet e duhura.</i>				
<i>Ka menaxhuar burimet financiare dhe burime të tjera të kopshtit, në funksion të shërbime cilësore për fëmijët parashkollorë.</i>				
<i>Ka qënë i përgjegjshëm, transparent dhe realizon procedurat e llogaridhënies personale në përdorimin e burimeve financiare.</i>				
<i>Ka zhvilluar marrëdhënie produktive me bordin e kopshtit, njësinë e qeverisjes vendore, njësinë arsimore vendore etj.</i>				
<i>Ka ndihmuar komunitetin e kopshtit të njohë kuadrin ligjor, të drejtat dhe detyrat e tyre, në mënyrë që të promovojnë suksesin e fëmijëve.</i>				
<i>Ka ruajtur konfidencialitetin e të dhënave të kopshtit dhe privatësinë.</i>				
<i>Ka përdorur në mënyrë efektive burimet financiare të disponueshme, për të ndikuar maksimalisht në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.</i>				
<i>Drejtuesi/ja i/e Kopshtit ka dërguar kërkesën për mësuës ndihmës në Njësinë Arsimore pranë Bashkisë së bashku me dokumentet që justifikojnë kërkesën për mësuës ndihmës, pas nevojës së shprehur në raportin e komisionit multidisiplinar në ZVAP.</i>				

Drejtuesi/ja disponon dosjet e plotësuar me dokumentacionin përkatës për të gjithë mësuesit e kopshtit.				
<b>Proceset e shërbimit të arsimit parashkollor</b>				
<b>Regjistrimi i fëmijëve në kopsht</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>
Drejtuesi/ja i/e kopshtit ka dërguar në Njësinë e Arsimit Parashkollor listën emërore të fëmijëve të regjistruar dhe dosjet me dokumentacionin e fëmijëve të regjistruar në kopsht, 3 javë pas fillimit të kopshtit dhe në dhjetor.				
Drejtuesi/ja i/e kopshtit para fillimit të procesit të regjistrimit ka urdhëruar ngritjen e një grupi pune të përbërë nga drejtuesi i kopshtit dhe mësuesit për regjistrimet e fëmijëve në kopsht.				
Drejtuesi/ja i/e kopshtit ka organizuar dokumentet për çdo fëmijë në dosje të veçantë.				
Në kopsht janë formuar grupet/klasat në përputhje me <b>Udhëzimin Nr. 14</b> , datë 10.07.2023, "Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve mësimorë në institucionet e arsimit parauniversitar" dhe <b>Rregullores "Për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë"</b> , miratuar me <b>Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, i ndryshuar</b> .				
<b>Organizmat e Institucionit Arsimor</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>
Organizmat e kopshtit kanë hartuar rregulloret për funksionimin e tyre dhe planet e punës.				
Drejtori realizon detyrat e tij për funksionimin efektiv të secilit organizëm të kopshtit.				
Drejtori i IA-së ka ngritur Komisionin e Shëndetit, të Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, të kryesuar prej tij ose një nëndrejtor i ngarkuar prej tij (nëse ka), të përbërë nga mësues të zgjedhur nga këshilli i mësuesve, persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të fëmijëve, të caktuar nga këshilli i prindërve.				
Drejtori i IA-së ka miratuar rregulloren e shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit.				
Komisioni i Shëndetit, të Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit ka mbikëqyrur rregullisht në IA kushtet e ruajtjes së shëndetit, të higjienës, pastërtisë, mjedisit, të sigurisë së nxënësve dhe punonjësve, si dhe mirëmbajtjen e mjediseve dhe të pajisjeve.				
Komisioni i Shëndetit, të Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit ka organizuar veprimtari ndërgjegjësuese me nxënës, mësues dhe persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësit, për kushtet e ruajtjes së shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes së mjediseve dhe pajisjeve të institucionit.				
Drejtori i IA-së ka përcaktuar udhëzime të qarta dhe të hollësishme për të përcaktuar masat parandaluese për emergjencat e mundshme.				
<b>Fëmijët me aftësi të kufizuar</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>

Drejtuesi/ja i/e kopshtit pasi është vënë në dijeni për praninë e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopsht, ka bërë kërkesë në Komisionin Multidisiplinor për vlerësimin e nevojave arsimore dhe shoqërore të fëmijës dhe performancës së tij.				
Drejtuesi/ja i/e kopshtit ka ngritur Komisionin e Zakonshëm të Kopshtit para se të raportojë në ZVAP.				
Drejtuesi/ja i/e kopshtit pasi ka identifikuar barrierat infrastrukturore që pengojnë aksesin në kopsht për fëmijët me aftësi të kufizuara i ka listuar dhe dërguar Bashkisë bashkë me kërkesën për heqjen e tyre.				
Kopshti identifikon fëmijët me prirje të veçanta, vështirësi në të nxënë dhe me aftësi të kufizuara (AK).				
<b>Materialet</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>
Drejtuesi/ja i/e Kopshtit i ka dërguar çdo muaj Qershor Njesisë së Arsimit Parashkollor pranë Bashkisë, nevojën për materiale didaktike dhe kancelarike.				
Kopshti bashkëpunon me ZVAP-në dhe pushtetin vendor për sigurimin e materialeve mësimore didaktike, literaturën artistike, profesionale dhe shkencore në funksion të arritjes së rezultateve të të nxënit.				
Drejtori ka ngritur komisionet për administrimin e inventarit sipas udhëzimeve zyrtare.				
<b>Ushqimi</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>
Drejtuesi/ja i/e kopshtit (për kopshtet me drekë) ka raportuar pranë Njesisë së Arsimit Parashkollor numrin e fëmijëve që frekuentojnë kopshtin.				
Drejtuesi/ja i/e kopshtit i ka dërguar Njesisë së Arsimit Parashkollor pranë Bashkisë, kërkesën për ushqime.				
Drejtuesi/ja i/e kopshtit ka ruajtur ushqimin 24 orë.				
Drejtuesi/ja i/e kopshtit ka planifikuar menunë dhe nevojën për ushqime të fëmijëve që frekuentojnë kopshtin.				
<b>Përfshirja Sociale</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>
Regjistrimi i fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale në kopsht.				
Frekuentimi i rregullt i fëmijëve në nevojë i programit kurrikular.				
<b>Fëmijët në nevojë për mbrojtje</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>
Drejtuesi ka raportuar pranë Bashkisë për rastet e identifikuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje (të abuzuar ose neglizhuar).				
<b>Higjiena</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>

Kopshti ka hartuar dhe zbaton udhëzime të qarta për mbajtjen e higjienës në të gjitha mjediset e kopshtit.				
Të gjitha mjediset e kopshtit janë të ajrosura dhe të ndriçuara, në përputhje me standardet.				
Drejtori i kopshtit informon dhe bashkëpunon me pushtetin vendor për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e mjediseve të kopshtit në përputhje me standardet kombëtare.				
Drejtuesi ka ndërmarr masat e nevojshme për sigurimin e kushteve higjeno-sanitare në respektim të kuadrit ligjor të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.				
<b>Komente:</b>				

**Ndarja B: Nënshkrimi**

1. Unë deklaroj se kam kryer vlerësimin e mësipërm.

**Nënshkrimi i Drejtuesit të Institucionit Arsimit**

**Data: .....**

### Shtojca 3

Model formati për pyetësin që prindërit, mësuesit, përfaqësuesi i bordit, do zhvillojnë për vlerësimin e drejtuesit të institucionit arsimor parashkollor.

#### Pyetësor për Prindërit

Kopshti: \_\_\_\_\_

Drejtuesi/ja i/e kopshtit: \_\_\_\_\_ (të përcaktohet për cilin drejtues bëhet pyetësi)

I dashur prind,

Ju kërkohet të shprehni mendimet për kopshtin e fëmijës tuaj konkretisht për drejtuesin e institucionit arsimor. Përgjigjet që do të jepni do të jenë shumë të vlefshme për përmirësimin e cilësisë së shërbimit që ofron kopshti ynë. Përgjigjet tuaja do të trajtohen në mënyrë konfidenciale, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky pyetësor zhvillohet për vitin shkollor 2020-2021.

Nr.	Pyetje	Po	Jo	Komente
1	A mendon se fëmija juaj ndihet mirë në kopshtin tonë?			
2	A i marrin parasysh drejtuesit e kopshtit tonë nevojat dhe interesat e fëmijës tuaj?			
3	A është orari i kopshtit tonë i përshtatshëm për familjen tuaj?			
4	A është stafi i kopshtit tonë mikpritës për ju?			
5	A mendoni se kopshti ynë është i pastër dhe i mirëmbajtur?			
6	A mendoni se kopshti ynë është i sigurt?			
7	A jeni të kënaqur me shërbimin e ofruar nga kopshti ynë?			
8	A jeni të kënaqur me marrëdhëniet e fëmijës tuaj me mësuesit?			
9	A është i disponueshëm drejtori të dialogojë me ju?			
10	A jeni të kënaqur nga marrëdhënia me drejtorin e kopshtit?			
11	A jeni të informuar rregullisht nga kopshti/ shkollës mbi ecurinë e fëmijës tuaj?			
12	A ndiheni të përfshirë në vendimmarrjet e kopshtit?			
13	A mendoni se kopshti/shkolla ka mjaftueshëm mjete dhe materiale didaktike mësimore?			
14	A jeni të informuar nga drejtorja e kopshtit/ shkollës mbi të gjitha aspektet dhe risitë?			
15	Cfarë do të dëshironit të ndryshonte në kopshte (komente)			

**SHTOJCA 4**

**Pyetësor për Mësuesit**

**Kopshti:** \_\_\_\_\_

**Drejtuesi/ja i/e kopshtit:** \_\_\_\_\_

*(të përcaktohet për cilin drejtues bëhet pyetësori)*

Mësues të dashur,

Ju kërkohet të shprehni mendimet për kopshtin ku jeni punësuar më konkretisht për drejtuesin e institucionit arsimor. Përgjigjet që do të jepni do të jenë shumë të vlefshme për përmirësimin e cilësisë së shërbimit që ofron kopshti ynë. Përgjigjet tuaja do të trajtohen në mënyrë konfidenciale, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky pyetësor zhvillohet për vitin shkollor 2020-2021.

Nr.	Pyetje	PO	JO	Komente
1	A mendoni se shërbimet në kopsht janë efikase?			
2	A i përdorni rregullisht mjetet didaktike mësimore?			
3	A mendoni se shkolla ka mjaftueshëm mjete dhe materiale didaktike mësimore?			
4	A jeni të kënaqur nga marrëdhëniet tuaja me drejtorin e shkollës?			
5	A jeni të informuar nga drejtoria e shkollës mbi të gjitha aspektet dhe risitë?			
6	A ndiheni të përfshirë në vendimmarrjet e shkollës?			
7.	Çfarë do të donit të ndryshonte në kopsht:			

**SHTOJCA 5**

**Pyetësor për Përfaqësuesin e Bashkisë pranë Bordit të Kopshtit**

Kopshti Nr. \_\_\_\_\_

Drejtuesi/ja i/e kopshtit nr. \_\_\_\_\_

*(të përcaktohet për cilin drejtues bëhet pyetësi)*

Në mbështetje të Ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzimit Nr. 25, datë 25.07.2018 "Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor, Urdhërit nr. 31, datë 28.01.2020 "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore në Republikën e Shqipërisë" përfaqësuesi i Bashkisë pranë Bordit të kopshtit \_\_\_\_\_, shpreh mendimet në lidhje me performancën dhe arritjen e objektivave në lidhje me strukturat e kopshtit të drejtuesit të institucionit arsimor parashkollor për vitin shkollor 2020-2021. Ky vlerësim do të jetë shumë i vlefshëm për përmirësimin e cilësisë së shërbimit.

Nr.	Pyetje	PO	JO	Komente
1	A janë ngritur organizmat e kopshtit, sipas procedurave të parashikuara në udhëzimet zyrtare?			
2	A është hartuar nga drejtuesi i kopshtit plani afatmesëm dhe vjetor për miratim nga Bordi?			
3	A është hartuar nga drejtuesi i kopshtit për miratim nga Bordi plani i shpenzimeve për fondet që siguron vet kopshti?			
4	A është realizuar për shqyrtim nga Bordi raporti vjetor financiar i kopshtit?			
5	A janë përmbushur objektivat e planit vjetor?			
6	A ka raportuar në Bord drejtuesi i kopshtit për çështje të mbarëvajtjes së kopshtit kur i është bërë kërkesë për raportim?			
7	Çfarë do të dëshironit të ndryshonte në kopshte? <i>(komente)</i>			



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
KËSHILLI BASHKIAK



Gramsh, më 22.04.2026

PROJEKT – VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_\_ . 2026

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PROCEDURËN E VLERËSIMIT TË  
PERFORMANCËS SË DREJTUESVE TË KOPSHTEVE”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 54 pika n, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 28, pika 4, shkronjat “a”, “b” dhe “d”, nenit 55/1 të Ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020 “Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore për arsimin parauniversitar”, i ndryshuar, Këshilli Bashkiak :

V E N D O S I

1. Miratimin e Rregullores “Për procedurën e vlerësimit të performancës së drejtuesve të kopshteve”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Sekretari i Këshillit të Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi bazuar në Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55, pika 6.

SEKRETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË  
Xhulia GJINI

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË  
Enis ZANI

Xh. Gjini



REPUBLIKA E SHIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
AGJENCIA E FUNKSIONEVE TË PATRANSFERUESHME  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Nr. 1665/2 Prot.

Gramsh, më 22.04.2026

**Lënda:** Dërgim projekt - vendimi për miratim.

**KËSHILLIT TË BASHKISË GRAMSH**

Bashkëlidhur po ju dërgojmë projektvendimin, si dhe relacionin për:

- Për miratimin e Rregullores për procedurën e vlerësimit të performancës së drejtuesve të kopshteve, së bashku me shtojcat, pjesë integrale e rregullores.

**Me konsideratë,**

**KRYETARI**  
**Besion AJAZI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE DHE MBROJTJES SOCIALE

Nr. 1634 Prot

Gramsh më 20/04 /2026

RELACION

**MBI PLANIN LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZI, PËRFSHIRJE DHE  
PJESËMARRJEN E ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE NË BASHKINË GRAMSH**

Mbështetur në Ligji 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", si dhe ligji 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" Bashkia Gramsh në bashkëpunim me organizatën Drejtësi Sociale ka përgatitur Planin lokal të veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje të romëve dhe egjiptianëve për të mbështetur reformën e shërbimeve të kujdesit shoqëror në Shqipëri në përgjigje të përpjekjeve të qeverisë shqiptare për të mundësuar përfshirjen sociale të grupeve në nevojë.

Edhe pse qeverisja lokale ka tashmë një nivel të ngritur të ndërgjegjësimit mbi nevojën për të ngritur e bërë funksional një sistem komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror për ata që kanë nevojë për këto shërbime, ajo ka kapacitete të kufizuara teknike dhe financiare për ti hartuar dhe kostuar planet e veprimit.

Hartimi i Planit Lokal të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë Gramsh për periudhën 2026–2030 paraqet një hap të rëndësishëm drejt garantimit të të drejtave të barabarta, përmirësimit të aksesit në shërbime dhe fuqizimit të pjesëmarrjes qytetare të komuniteteve rome dhe egjiptiane në nivel vendor. Ky plan bazohet në parimet e gjithëpërfshirjes, bashkëpunimit ndërinstytucional dhe pjesëmarrjes aktive të vetë komuniteteve si aktorë të ndryshimit.

Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit mes Qendrës Drejtësi Sociale dhe Bashkisë Gramsh është vetëm një fazë e procesit, por njëherazi dëshmi e gatishmërisë për hartimin dhe zbatimin e politikave lokale që synojnë krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët pavarësisht përkatësisë së tyre etnike apo statusit socio-ekonomik.

Ky plan është hartuar falë kujdesit, angazhimit dhe bashkëpunimit të Drejtorisë së Shërbimeve dhe Mbrotjtjes Sociale të Bashkisë Gramsh dhe institucioneve si Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Gramsh, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor dhe Zyra Vendore e Punësimit, Gramsh.

Gjithashtu shprehim mirënjohje të thellë ndaj përfaqësuesve të pakicave rome dhe egjiptiane, që kanë mundësuar reflektimin e nevojave reale të komuniteteve respektive dhe kanë bërë të mundur hartimin e një plani solid që mund të ndihmojë në përmirësimin sistematik të kushteve të tyre të jetesës në bashkinë Gramsh.

Plani Lokal i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë Gramsh (2026-2030) është një dokument strategjik i domosdoshëm sepse mbart përmasën e një politike lokale themelore që mund dhe duhet të bëhet referencë kyçe për të gjithë institucionet në nivel qendror dhe vendor, organizatat jo fitim-prurëse dhe cdo aktor që synon përmirësimin e kushteve të jetesës si dhe integrimin e pakicës rome dhe pakicës egjiptiane brenda

territorit të bashkisë Gramsh. Hartimi i planeve strategjike të këtij lloji janë njëherazi manifestim i vullnetit të pushtetit lokal për të krijuar kushte të barabarta për të gjithë qytetarët.

## **METODOLOGJIA PËR HARTIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZI, PËRFSHIRJE DHE PJESËMARRJEN E ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE NË BASHKINË GRAMSH (2026-2030)**

Për hartimin e Planit në Bashkinë Gramsh, është aplikuar një metodologji gjithëpërfshirëse duke siguruar përfshirjen aktive të komunitetit rom dhe egjiptian, institucioneve lokale, organizatave jo fitimprurëse dhe aktorëve të tjerë të interesuar.

Hartimi i Planit u mbështet në një analizë të detajuar të të dhënave sasiore dhe cilësore, duke përfshirë burime primare dhe sekondare informacioni, të mbledhura në bashkinë Gramsh. Metodologjia e përdorur për kërkimin ka përfshirë disa teknika si:

- Takime/fokus grupe me komunitetet rome dhe egjiptiane;
- intervista gjysmë të strukturuar me aktorë kyc në këto komunitete;
- të dhëna statistikore dhe publikime.

Workshop me përfaqësues të institucioneve lokale të bashkisë Gramsh

Mbledhja e të dhënave është mundësuar përmes punës në terren nga ekspertët dhe përfaqësuesit e organizatës Drejtësi Sociale duke u bazuar në takime direkte me komunitetet rome dhe egjiptiane (në takime individuale ose fokus grupe), si dhe në biseda me aktorë nga strukturat shtetërorë dhe jo-shtetërorë në nivel lokal.

Plani është konsultuar me një sërë përfaqësues të strukturave të ndryshme, si:

- -Bashkia Gramsh
- -Drejtoria e Shërbimeve dhe Mbrojtjes Sociale
- - Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor
- -Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Gramsh,
- -Zyra Vendore e Punësimit, Gramsh
- -Përfaqësues të pakicave rome dhe egjiptiane

► Plani Lokal i Veprimit do të fokusohet në këto fusha kryesore:

1. **Arsimi dhe trashëgimia kulturore** – Përmirësimi i qasjes dhe cilësisë së arsimit për fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian, si dhe promovimi i trashëgimisë kulturore.
2. **Punësimi dhe mbrojtja sociale** – Rritja e mundësive të punësimit dhe forcimi i shërbimeve sociale.
3. **Strehimi dhe infrastruktura** – Sigurimi i strehimit të përshtatshëm dhe përmirësimi i kushteve infrastrukturore.
4. **Shëndetësia** – Garantimi i qasjes së barabartë në shërbimet shëndetësore.
5. **Përfshirja sociale dhe mundësitë e barabarta** – Promovimi i pjesëmarrjes aktive në jetën publike dhe sociale.

Çdo fushë që përfshihet në planin e veprimit është trajtuar me kujdes duke specifikuar aktivitete konkrete, indikatorët, aktorët përgjegjës, mbështetjen e nevojshme si dhe buxhetin e parashikuar, duke identifikuar burimet financiare potenciale nga pushteti qendror, lokal ose donatorët.

► Objektivat Strategjike që synohen të arrihen gjatë zbatimit të këtij plani janë;

- Anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane në Bashkinë Gramsh do të kenë akses të plotë në shërbimet e gjendjes civile dhe ndihmës ligjore falas, me të gjithë ata të regjistruar në regjistrat e gjendjes civile.
- Fuqizimi ekonomik i individëve dhe familjeve nga pakicat rome dhe egjiptiane do të arrihet përmes mundësive të punësimit të rregullt dhe të qëndrueshëm.
- Anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane do të kenë një nivel më të lartë arsimor dhe akses më të mirë në arsimim cilësor dhe gjithëpërfshirës, përfshirë ata që janë kthyer nga emigracioni, në Bashkinë Gramsh.
- Ruajtja e diversitetit kulturor dhe promovimi i vlerave rome dhe egjiptiane do të jenë prioritete kyçe.
- Anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane do të kenë akses të plotë në shërbimet e strehimit dhe do të jetojnë në kushte më të mira strehimi dhe infrastrukture.
- Do të përmirësohet shëndeti dhe aksesin në shërbimet shëndetësore për anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane.
- Rritja e mirëqenies sociale për këto grupe do të jetë një fokus i rëndësishëm.
- Do të eliminohet antixhipsizmi përmes njohjes dhe edukimit të shoqërisë, për të siguruar një mjedis të lirë nga diskriminimi ndaj këtyre grupeve.
- Fuqizimi i pakicave rome dhe egjiptiane do të arrihet përmes statistikave, planifikimit dhe buxhetimit të ndjeshëm ndaj diversitetit rom dhe egjiptian

Ky Plan përputhet me kuadrin ligjor dhe politik kombëtar dhe ndërkombëtar që garanton dhe detyron respektimin e të drejtave të pakicave kombëtare, si dhe siguron mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët, pavarësisht përkatësive të tyre.

Nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të këtij plani në të ardhmen, Bashkia Gramsh shpreh plotësisht angazhimin e saj për një shoqëri më të drejtë dhe më gjithëpërfshirëse, duke kontribuar kështu në stabilitetin social dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

**Dr.Drejtorisë së Shërbimeve dhe Mbrojtjes Sociale .**

Elisabeta Xhepexhiu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KESHILLI BASHKIAK  
GRAMSH

Nr. 16.34/Prot

Gramsh më 20/04/2026



**PROJEKT-VENDIM**  
Nr \_\_\_\_ Date \_\_\_\_/\_\_\_\_/2026

**PËR  
MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT 2026-2030 PËR BARAZI,  
PËRFSHIRJE DHE PJESËMARRJE TË ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE NË  
BASHKINË GRAMSH**

Keshilli Bashkiak ne mbledhjen e dates \_\_\_\_/\_\_\_\_/ 2026, pasi mori në shqyrtim Relacionin e Drejtorisë së Shërbimeve dhe Mbrojtjes Sociale , Për, Planin Lokal të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2026-2030 për Bashkinë Gramsh, mbështetur në Ligji 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, si dhe ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”.

**VENDOSI:**


1. Të miratojë Planin Lokal të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2026-2030 për Bashkinë Gramsh nga i cili synohet të arrihen objektivat e mëposhtëm:

- Anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane në Bashkinë Gramsh do të kenë akses të plotë në shërbimet e gjendjes civile dhe ndihmës ligjore falas, me të gjithë ata të regjistruar në regjistrat e gjendjes civile.
- Fuqizimi ekonomik i individëve dhe familjeve nga pakicat rome dhe egjiptiane do të arrihet përmes mundësive të punësimit të rregullt dhe të qëndrueshëm.
- Anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane do të kenë një nivel më të lartë arsimor dhe akses më të mirë në arsimim cilësor dhe gjithëpërfshirës, përfshirë ata që janë kthyer nga emigracioni, në Bashkinë Gramsh.
- Ruajtja e diversitetit kulturor dhe promovimi i vlerave rome dhe egjiptiane do të jenë prioritete kyçe.
- Anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane do të kenë akses të plotë në shërbimet e strehimit dhe do të jetojnë në kushte më të mira strehimi dhe infrastrukture.
- Do të përmirësohet shëndeti dhe aksesin në shërbimet shëndetësore për anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane.
- Rritja e mirëqenies sociale për këto grupe do të jetë një fokus i rëndësishëm.
- Do të eliminohet antixhipsizmi përmes njohjes dhe edukimit të shoqërisë, për të siguruar një mjedis të lirë nga diskriminimi ndaj këtyre grupeve.

•Fuqizimi i pakicave rome dhe egjiptiane do të arrihet përmes statistikave, planifikimit dhe buxhetimit të ndjeshëm ndaj diversitetit rom dhe egjiptian

2. Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Shërbimeve dhe Mbrojtjes Sociale.


**Dr.Drej.Shërbimeve dhe Mbrojtjes Sociale**  
**Elisabeta Xhepexhiu**



**Sekretari Keshillit**  
**Xhulia Gjini**



**Dr.Drej. Finances dhe Buxhetit**  
**Ermal Hysa**



**Kryetari Keshillit**  
**Enis Zani**